

VENDIM
Nr.782, datë 29.9.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të pikës 3, të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Prokuroria e Përgjithshme të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të shpërbimit të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, për merita profesionale në punë.”.

2. Në fund të shkronjës “dh” shtohen paragrafët me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Transportit dhe Punëve Publike, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) furnizim dhe vendosje e guardrailit në aksin Morinë-Kalimash;

ii) studim, projektim aksi Qafëpulloçë-Pogradec;

iii) ujësjellësi i jashtëm i qytetit Bajram Curri;

iv) ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, për zonën e plazhit, Durrës-Kavajë.

“Përfundimisht, lejohet Gjykata Kushtetuese, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) blerje e shërbimit të programit të menaxhimit të çështjeve të internetit të brendshëm;

ii) blerje e pajisjeve kompjuterike.

“Përfundimisht, lejohet INSTAT-i, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) blerje materialesh për regjistrimin;

ii) publikime për njësinë e regjistrimit.

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Mbrojtjes, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) rikonstrukcion QKU, ESKU, Tiranë, Reparti Ushtarak nr.4400;

ii) ndërtim kabine elektrike, Kroi i Bardhë, Kukës, “SHIU”;

iii) ndërtim rrjeti elektrik në Repartin Ushtarak nr.1320, Tiranë;

iv) blerje materialesh speciale zbulimi (materiale për misionin në Afganistan);

v) blerje materialesh ndërlidhjeje, SNI;

vi) Wireless PTT (materiale për misionin);

vii) blerje aksesorësh shtesë të komandimit në distancë (për misionin në Afganistan);

viii) blerje artikujsh ushqimorë për Forcën Detare (Garnizoni i Vlorës).

ix) blerje gazi të lëngët;

x) materiale për ngrohje e gatim;

xi) blerje karburanti JET-A1;

xii) blerje gomash e baterish për automjetet e angazhuara në transportin e municioneve të

tepërta;

- xiii) shërbim larje teshash;
- xiv) lëndë djegëse për ngrohje e gatim;
- xv) blerje lëndësh djegëse për ngrohje;
- xvi) blerje artikujsh ushqimorë;
- xvii) blerje protoxid azoti;
- xviii) blerje kitesh laborator;
- xix) blerje medikamentesh mjekësore;
- xx) blerje dezinfektantësh;
- xxi) blerje materialesh mjekimi;
- xxii) blerje materialesh për mirëmbajtje kazermimi;
- xxiii) materiale për funksionimin e pajisjeve speciale;
- xxiv) materiale, shërbime speciale, mirëmbajtje, skaner etj.;
- xxv) blerje gazi të lëngshëm për ngrohje dhe gatim.

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

- i) rikonstrukcion i Inspektoratit Shtetëror të Punës;
- ii) mbikëqyrja e punimeve të rikonstrukcionit të ISHP-së;
- iii) kolaudimi i punimeve të rikonstrukcionit të ISHP-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha